



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 66 Prot

Tiranë, më 31.07 2007

VENDIM Nr. 16 dt. 27.07.2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 27.07.2007, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

Në lidhje me pikën 4, të rendit të ditës: (Cilat objekte do të kalojnë në KKR?)

- Bazuar në nenin 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Çdo projekt restaurimi i paraqitet KKR, e cila do të përcaktojë kriteret dhe kategorinë e projekteve që do të miratohen nga IMK.

Në lidhje me pikën 5 të rendit të ditës: (Diskutim mbi procedurën e shqyrtimit të projekteve)

- Kjo pikë do të diskutohet mbledhjen e ardhshme

Në lidhje me pikën 6 të rendit të ditës: (Vendosja e kriterëve për specialistët e Drejtorive Rajonale, në mënyrë që tu njihet e drejta e hartimit të projekteve)

- Ti kalojë kompetencën IMK, për të përcaktuar kriteret për aftësimin profesional të punonjësve të IMK dhe të Drejtorive Rajonale të Monumenteve të Kulturës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
PROF. DR. YLLI PANGO

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO